

20130230715

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE TË
TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 115/2007, 18/11 dhe 148/11), në nenin 63 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Lejen nga paragrafi (1) të këtij neni Drejtoria e lëshon me pëlqim paraprak të ministrit të Kulturës."

Paragrafët (2), (3), (4), (5) dhe (6) bëhen paragrafë (3), (4), (5), (6) dhe (7).

Pas paragrafit (7) shtohet paragraf i ri (8), si vijon:

"(8) Ministria e Kulturës dy herë në vit, në janar dhe në korrik të vitit rrjedhës, detyrohet që ta informojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për atë se kujt i janë lëshuar lejet nga paragrafi (1) i këtij neni, cilat janë efektet nga lejet e lëshuara, për parashtruesit e rinj të kërkesave për leje dhe sa lëndë për lëshim të lejes janë në procedurë."

Neni 2

Në Seksionin 11 titulli i pikës 11.1 ndryshohet si vijon: "Koncesione dhe partneriteti privat publik".

Neni 3

Titulli para nenit 117 dhe neni 117 ndryshohen, si vijnë:

"Lënda e koncesionit dhe partneriteti privat publik

Neni 117

(1) Në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore interesi publik mund të realizohet edhe nëpërmjet koncesionit ose me vendosjen e partneritetit privat publik, në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik.

(2) Lëndë e ndarjes së koncesionit dhe e kryerjes së partneritetit privat publik mund të jetë trashëgimia kulturore me interes publik dhe realizimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore me interes publik në pajtim me këtë ligj, me përjashtim të:

1) zonave të rezervuara arkeologjike dhe vendzbulimeve tjera arkeologjike të pahulumtuara apo të hulumtuara jotërësisht;

2) objekteve memoriale, shenjave dhe vendeve të lidhura me ngjarje të rëndësishme dhe personalitete të shquara;

3) vendeve të kultit apo vendeve dhe objekteve tjera të lidhura me zakone, besime ose tradita të veçanta dhe

4) të mirave të patundshme nga nenet 12 paragrafi (2) dhe 13 paragrafi (2) i këtij ligji.

(3) Ndarja e koncesionit dhe vendosja e partneritetit privat publik nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar në Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik, në pajtim me kushtet e veçanta të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Koncesioni nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të bartet."

Neni 4

Në nenin 118 paragrafi (1) pas fjalës: "vijim" shtohen fjalët: "të veçanta".

Pika 1 ndryshohet si vijon:

"1) të jetë i regjistruar në vendin amë për kryerjen e veprimtarisë për të cilën ndahet e drejta e shfrytëzimit të trashëgimisë kulturore të patundshme lëndë e koncesionit;"

Në pikën 2 fjalët: "për të cilën është regjistruar" zëvendësohen me fjalët: "nga pika 1".

Neni 5

Neni 119 ndryshohet si vijon:

"(1) Koncesioni nga neni 117 paragrafi (1) i këtij ligji jepet për periudhë prej më së shumti 30 vite.

(2) Për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore që është lëndë e koncesionit nga neni 117 paragrafi (1) i këtij ligji paguhet kompensim vjetor, lartësia e të cilit përcaktohet me marrëveshje për koncesion.

(3) Kompensimi nga paragrafi (2) i këtij neni paguhet deri më 30 qershor për vitin rrjedhës."

Neni 6

Neni 120 ndryshohet si vijon:

"(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e marrëveshjeve për ndarje të koncesionit dhe për kryerjen e partneritetit privat publik kryen Ministria e Kulturës.

(2) Ministria e Kulturës mundet me aktvendim të caktojë këshill të veçantë për mbikëqyrje mbi zbatimin e marrëveshjeve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Në këshillin për mbikëqyrje mbi zbatimin e marrëveshjes për koncesion emërohen edhe nga një përfaqësues i komunës në rajonin e së cilës gjendet e mira e koncesionit dhe i organizatës joqeveritare nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore."

Neni 7

Në nenin 173 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) pika 8 të këtij ligji, personit juridik dhe personit fizik mund t'i shqiptohet masë e veçantë kundërvajtëse konfiskim i sendeve, detektorëve metalikë dhe mjeteve tjera teknike të përshtatshme për detektim nga neni 63 i këtij ligji, me të cilat është kryer kundërvajtja."

Paragrafët (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (6), (7) dhe (8).

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".